

## **Akt Themelimi**

**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**“007 Investigation Services “ sh.p.k**

### **Neni 1 Formimi**

Sot në Durrës më datë 21.08.2023 themeluesit që firmosin më poshtë:

1. **Arturo Gjyshi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18.12.1994 , lindur në Itali, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. J41218002M

Në bazë të Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Ligjit Nr.9723, dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” themelojme me vullnetin tone të lirë Shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “007 Investigation Services “ sh.p.k

### **Neni 2 Selia**

Selia e shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “007 Investigation Services “ sh.p.k është në adresën:

Tirane, Lagjja Nr.10, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pall.16, Shkalla 10, Nr.9, Kati i dyte, sipër dyqanit “Pandora”

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “007 Investigation Services “ sh.p.k është pa afat nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB-se.

#### **Neni 4**

#### **Objekti i Veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “ 007 Investigation Services “ sh.p.k është:

Investigim privat. Kerkimi, gjetja dhe mbledhja e informacioneve personale, familjare, tregtare dhe industriale, te mbartura, te humbura ose aktuale te cilat cojne ne zbardhjen e veprave te konsumuara me karakter penal, civil ose administrativ, ose te informacioneve qe bejne te mundur parandalimin e tyre. Te investigoje, me qellim vertetimin e ekzistences se marredhenieve jashtemartesorë sipas kerkeses se njerit prej partnereve, ne cdo rast duke respektuar privatesine sipas ligjit mbi mbrojtjen e te dhenave personale. Ne mbrojtjen e sekreteve industriale, investigimin mbi markat dhe patentat e falsifikuara. Te investigoje dhe te grumbulloje prova per ceshtjet e pabesueshmerise te ortakeve ne biznes si dhe mbi konkurrencen e pandershme dhe jo te vertete. Te kryeje investigime per gjetjen e personave te humbur, bazuar ne kerkesen e familjareve dhe te te interesuarve, si dhe personat qe kerkohen nga organet shteterore. Te siguroje prova, fakte, indicie, materiale dhe informacione per llogari te pales mbrojtese ne procesin penal, si dhe te perfaqesuesve te paleve mbrojtese ne proceset civile dhe administrative. Gjetja e vendndodhjeve dhe konfiskimi i pasurive te paluajtshme, te mjeteve motorrike dhe asetëve qe rezultojne te vjedhura dhe/ose ne pronesi te paleve te treta. Kerkime mbi identitetin, sjelljet, profesionin, reputacionin, integritetin, besueshmerine, levizjet, transaksionet dhe bizneset qe drejtojne, personat me te cilet kryhet biznes ose do te ndertohet nje marredhenie e re biznesi. Shkaku ose pergjegjesia per renien e zjarrit, humbjeve, aksidenteve, demeve, plagosjeve te personave te demit te prones dhe imazhit nga shpifjet. Kryerjen e dy veprimeve ne fushen e zbulimit dhe kunderzbulimit, survejim/kundersurvejim, fiksime te kontakteve me videofilmim. Grumbullon informacion te klasifikuar mbi ngjarje te mprehta, terrorizmin, korrupsionin pasiv/aktiv dhe pastrimin e produktit kriminal per ta koordinuar me strukturat ligjzbatuese

#### **Neni 5**

#### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali fillestar i shoqërisë “007 Investigation Services “ sh.p.k është 100.000 lekë dhe i përbërë nga 1 kuote sipas kontributit të ortakut

**1. Arturo Gjyshi**, në masën 100% (Njeqind përqind)

Ky kapital do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të regjistrohet në QKB

Kapitali fillestar eshte i nenshkruar dhe shlyer teresisht nga themeluesi, ai mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marrin ortakët , por asnjëherë nuk mund te pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar. Do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet në Q.K.B.

## **Neni 6**

### **Organet e Shoqërisë dhe Asambleja**

Organet drejtuese të shoqërisë "007 Investigation Services " sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendimmarrës.
- Administrator është Z. **Arturo Gjyshi**.
- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet.

## **Neni 7**

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në Status që bashkë me Aktin e Themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

## **Neni 8**

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

## **Neni 9**

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti,statuti si dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me Gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "007 Investigation Services " sh.p.k në QKB, në këtë ditë shoqëria "007 Investigation Services " sh.p.k njihet si person juridik.

**Ortaku**  
**Arturo Gjyshi**